



Taksë e pulles
u likujdua

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SAIMIR S. SHARKA
ADRESA ASTRIT BALLUKU
TEL: 0692087887



MARRËVESHJE SIGURUESE


Nr. repertori: 1359

Nr. koleksioni: 346

Tirane më 16/08/2023

Ligjet referuese:

- 1.Liqji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Liqji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Liqji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2023052680037490267

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBETARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NR. 1358 REP.
NR. 346 KOL.



MARRËVESHJE SIGURUESE

Sot më datë 16/8/2023, përpara meje, Noteres Salimir Sharka, anetare e Dhomës se Noterisë Tiranë, me Zyrë Notariale në Tiranë, A. Balliu u paraqitën palët si më poshtë:

BARRËDHËNËSI: Znj. Artenisa Sali, shtetase shqiptare, e bija e Refat, lindur në Vlore, më dt. 24.02.1993, banues në Tirane, mbajtëse e Letërnjoftimit me Nr.034563316 dhe nr.personal J35224075H, me gjendje civile “beqar” (më poshtë referuar si “**Barrëdhënësi**”).

Z. Refat Sali, shtetas shqiptar, i biri i Veip, lindur ne Varosh, më dt. 26.08.1959, banues në Tirane, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr.033677028 dhe nr. personal me Nr. F90826091J, me gjendje civile “i martuar” (më poshtë referuar si “**Barrëdhënësi**”)

BARRËMARRËSI: “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SHA, me Numër Unik të Identifikimit (NUIS) J81817006P, regjistruar me Vendim nr. 19460, date 19.05.1998, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me seli në Rr. Ismail Qemali, nr. 27, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar prej Ermenita Harasani, shtetase shqiptare, lindur ne Tiranë, me 03.03.1971, identifikuar me nr. personal H15303195N dhe nga **Z. Silvi Balliu**, shtetas shqiptar, lindur ne Gramsh, më 19.07.1990, identifikuar me nr. personal J00719088P, ne cilësinë e përfaqësuesve te Bankës. (më poshtë referuar si “**Barrëmarrësi**”).

me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilëve, unë noterja jam e sigurt, të cilët më deklaruan se:

Meqënëse:

- A. Barrëmarrësi në cilësinë e Kredidhënësit ka lidhur me Kredimarrës: “SUNPOWER 2017” SHPK (këtu e më poshtë referuar si “Kredimarrësi”) eshte lidhur Kontraten e Kredisë Bankare me nr. 1356 rep./nr. 343 kol., datë 16/8/2023 (këtu e më poshtë referuar si “Kontrata e Kredisë”), me shumë principali 1,350,000 (një milion e treqind e pesëdhjete mijë) Euro (këtu e më poshtë referuar si “Principali”);
- B. Për qëllime të garantimit të shlyerjes së detyrimeve që lindin për ‘Kredimarrësin’ nga ‘Kontrata e Kredisë’, kërkohet barrë siguruese në favor të Barrëmarrësit mbi kolateralin – objekt të kësaj marrëveshje siguruese;

Atëherë,


Palet, me vullnet të lirë dhe të plotë, bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Siguruese me përbajtjen si më poshtë vijon:

Neni 1 - Përkufizime

1.1 Kudo, ku përdoren në këtë Marrëveshje Siguruese, dhe vetëm nëse shprehimisht parashikohet ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- “Kolateral” – nënkuption pasurinë e luajtshme (të prekshme apo të paprekshme), objekt i kësaj Marrëveshje Siguruese. Kolaterali mund të ekzistojë ose mund të krijohet në të ardhmen dhe nuk kufizohet vetëm me pasuritë e luajtëshme mbi të cilat Barrëdhënësi ka pronësinë apo një të drejtë të tashme. Kolaterali mund të ndodhet kudo, brenda apo jashtë Shqiperisë, dhe përfshin edhe të ardhurat kolateral. Përshkrimi i Kolateralit jepet në nenin 2.1 të kësaj Marrëveshje Siguruese.
- “Barrë Siguruese” – nënkuption të drejtën reale mbi ‘Kolateralin’, nëpërmjet se cilës sigurohet përbushja e detyrimeve të rrjedhura për ‘Kredimarrësin’ nga ‘Kontrata e Kredisë’.
- “Detyrime të Siguruara” – nënkuption detyrimin, që ka ‘Kredimarrësi’ për të përbushur të gjitha detyrimet sipas ‘Kontratës së Kredisë’, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në pagimin e shumës

totale të ‘Principalit’, interesave dhe penaliteteve deri në ditën e shlyerjes totale të të gjitha detyrimeve të ‘Kredimarrësit’, së bashku më çdo shumë tjetër sipas ‘Kontratës së Kredisë’, si dhe pagimin e çdo shpërblimi, shpenzimi, ose pagesa të tjera të lidhura me ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimeve të ‘Kredimarrësit’ sipas ‘Kontratës së Kredisë’ dhe Legislacionit Shqiptar.



Neni 2 - Barra Siguruese

2.1. Me qëllim që të sigurojë ekzekutimin e plotë të ‘Detyrimeve të Siguruara’ të rrjedhura për ‘Kredimarrësin’ nga ‘Kontrata e Kredisë’, ‘Barrëdhënësi’, nëpërmjet kësaj Marreveshje Siguruese, vendos në favor të ‘Barrëmarrësit’, ‘Barra Siguruese’ te rradhes se pare mbi ‘Kolateralin’ e përshkruar më poshtë:

- **40% (dyzete perqind) te kuotave te kapitalit themeltar zoteruar nga ortaku Artenisa Sali, prane shoqerise “SUNPOWER 2017” si dhe cdo te drejte, titull dhe interes lidhur me to;**
- **60% (gjashtdhjete perqind) te kuotave te kapitalit themeltar zoteruar nga ortaku Refat Sali prane shoqerisë “SUNPOWER 2017” si dhe cdo te drejte, titull dhe interes lidhur me to;**

2.2. ‘Barra Siguruese’ e krijuar sipas kesaj Marreveshje do të jetë detyruese e do të mbetet në fuqi për ‘Barrëdhënësin’, pasardhësit e tij apo posedues dhe përfitues të tjerë të kolateralit, dhe do të përbëjë një garanci të panderprerë, pavarësisht nga shlyerja e pjesshme e ‘Detyrimeve te Siguruara’ dhe nuk do të cënohet nga ndonjë barrë, garanci apo mjet tjetër sigurimi të vendosur në favor të ‘Barrëmarrësit’ nga ‘Barrëdhënësi’ apo të tretë.

Neni 3 – Regjistrimi i Barrës Siguruese

3.1. Nëpërmjet kësaj Marrëveshje Siguruese, ‘Barrëdhënësi’ jep miratimin e tij, që sipas gjykimit dhe vendimit të vetëm të ‘Barrëmarrësit’, ‘Barra Siguruese’ e krijuar me këtë Marrëveshje Siguruese, të regjistrohet nga ‘Barrëmarrësi’ me shpenzimet e ‘Barrëdhënësit’, në Regjistrin e Barrëve Siguruese, në përputhje me Ligjin nr. 8573, datë 18.10.1999 “Për Barrët Siguruese”.

3.1.1. Përveç regjistrimit në Regjistrin e Barrëve Siguruese, ‘Barrëdhënësi’ jep miratimin e tij, që sipas gjykimit dhe vendimit të vetëm të ‘Barrëmarrësit’, ‘Barra Siguruese’ dhe/ose kjo ‘Marrëveshje Siguruese’ të regjistrohet, me shpenzimet e ‘Barrëdhënësit’, edhe në regjistra apo regjistrarë kompetentë, nëse në varësi të llojit të ‘Kolateralit’, një regjistrim i tillë është i nevojshëm sipas legjisacionit të zbatueshëm.

3.2. ‘Barrëdhënësi’ kupton plotësisht dhe bie dakord se nëse ‘Barrëmarrësi’ është ose vihet në posedim të ‘Kolateralit’, atëherë për efekte të preferimit kundrejt të tretëve sipas Ligjit nr. 8573, datë 18.10.1999 “Për Barrët Siguruese”, barra siguruese do të konsiderohet e kompletuar edhe me anë të vendosjes së ‘Barrëmarrësit’ në posedim të ‘Kolateralit’.

3.3. ‘Barrëmarrësi’ merr përsipër se do të bëjë të mundur heqjen e barrës siguruese mbi ‘Kolateralin’, vetëm pas përbushjes së plotë të të gjitha ‘Detyrimeve të Siguruara’.

3.4. ‘Barrëdhënësi’ i jep të drejtë ‘Barrëmarrësit’, që me shpenzimet e ‘Barrëdhënësit’ të térheqë nga organet kompetente, në çdo moment dokumentacionin provues të regjistrimit të ‘Barrës Siguruese’, ose vërtetimet mbi gjendjen juridike të ‘Kolateralit’.

Neni 4 – Deklarime dhe Garanci të ‘Barrëdhënësit’

4.1. ‘Barrëdhënësi’ deklaron dhe garanton ‘Barrëmarrësin’, se mbi ‘Kolateralin’ objekt të kësaj Marrëveshje Siguruese, nuk rëndon asnjë barrë siguruese (përvec sa shprehimisht parashikohet në këtë Marrëveshje Ssiguruese) në lidhje me ndonje detyrim tjetër, dhe se ‘Barredhënësi’ është titullari i vetëm i pronësisë mbi ‘Kolateralin’.

4.2. ‘Barrëdhënësi’ merr përsipër, që deri në momentin e shlyerjes së plotë të të gjitha ‘Detyrimeve të Siguruara’, të mos kryejë mbi ‘Kolateralin’ asnjë veprim juridik barrësimi, tjetërsimi, disponimi (material apo juridik), ndarje, bashkimi, pjestimi, pa pëlqimin paraprak me shkrim të ‘Barrëmarrësit’.

4.3. ‘Barrëdhënësi’ kupton plotësisht dhe pranon që në qoftë se ‘Kolaterali’ humbet ose dëmtohet qoftë dhe për rast fator, në mënyrë që të mos dëmtohen të drejtat e ‘Barrëmarrësit’, kjo e fundit mund të kërkojë nga ‘Barrëdhënësi’, që t’i jepet garanci e plotë mbi sende të tjera dhe, në mungesë të saj, mund të kërkojë pagesën e menjëherëshme të detyrimeve të rrjedhura nga ‘Kontrata e Kredisë’. I njëjti rregullim do të jetë i zbatueshëm edhe nëse ‘Barra Siguruese’ humbet ose cënohet pjesërisht apo totalisht, nga ndonjë e metë juridike e titullit të pronësisë apo e statusit juridik të ‘Kolateralit’.

4.4. ‘Barrëdhënësi’ kupton plotësisht dhe pranon që në rast të fillimit nga ana e ‘Barrëmarrësit’ të procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm për detyrimet e ‘Kredimarrësit’ të rrjedhura nga ‘Kontrata e Kredisë’, ‘Kolaterali’ sipas gjykimit dhe diskrecionit të vetëm të ‘Barrëmarrësit’ do t’i nënshtrohet procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, pavarësisht nëse kanë filluar ose jo procedurat përbartimore edhe mbi pasuritë e

printed at
www.printed.al

tjera të luajtshme apo të paluajtshme të ‘Kredimarrësit’, ose Dorezanësit/(ve), ose mbi pasuri tjetër të vendosur në hipotekë apo në barrë siguruese në favor të ‘Barrëmarrësit’ si garanci për shlyerjen e ‘Detyrimeve të Siguruara’.

4.5. ‘Barrëdhënësi’ deklaron se kuption plotësisht, dhe bie dakord që, ‘Barra Siguruese’ e krijuar në bazë të kësaj Marrëveshje Siguruese, duke qënë një e drejtë reale me titullar ‘Barrëmarrësin’, nuk do të cënohet apo preket, pavarësisht nëse ‘Barrëmarrësi’ dhe ‘Kredimarrësi’ vendosin të ndryshojnë kushtet e ‘Kontratës së Kredisë’ dhe për këtë qëllim nënshkruajnë me njëra – tjetër amendamente të ‘Kontratës së Kredisë’.

4.6. ‘Barrëdhënësi’ deklaron se kuption plotësisht që kjo Marrëveshje Siguruese përbën titull ekzekutiv dhe se nëse ndodh një ‘Rast Shkakësor’ sikundër përcaktohet në ‘Kontratën e Kredisë’, atëherë ‘Barrëmarrësi’ sipas vendimit dhe diskrecionit të vetëm të tij, do të mund të fillojë kërkimin e shlyerjes së ‘Detyrimeve te Siguruara’ nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm të ‘Kolateralit’, duke u bazuar në Ligjin nr. 8573, datë 18.10.1999 “Për Barrët Siguruese”, si dhe në “Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 5 - Detyrime të Barrëdhënësит

5.1. ‘Barrëdhënësi’ do të përbushë të gjitha detyrimet e parashikuara për të, në këtë Marrëveshje Siguruese dhe legjisacionin në fuqi, si dhe do të respektojë cdo deklarim dhe garanci të dhënë në këtë Marrëveshje Siguruese.

5.2. ‘Barrëdhënësi’ do të mbajë ‘Kolateralin’ në kushte të mira dhe do të kryejë të gjitha riparimet e nevojshme të tij, dhe nuk do të kryejë apo lejojë asnjë humbje apo dëmtim material të ‘Kolateralit’.

5.3. Nëse do t’i kërkohet nga ana e ‘Barrëmarrësit’, ‘Barrëdhënësi’ do të sigurojë ‘Kolateralin’ në favor të ‘Barrëmarrësit’, për të gjithë shumën e ‘Principalit’ dhe për të gjithë kohëzgjatjen e ‘Kontratës së Kredisë’, përkundrejt çdo lloj rreziku që do t’i kërkohet nga ana e ‘Barrëmarrësit’. ‘Barrëdhënësi’ do të mbajë të përjashtuar ‘Barrëmarrësin’ nga përgjegjësia për kryerjen e pagesave të shpenzimeve për sigurimin e ‘Kolateralit’.

5.4. ‘Barrëdhënësi’ garanton ‘Barrëmarrësin’ lidhur me vlefshinërinë e ‘Barrës Siguruese’ të krijuar në favor të ‘Barrëmarrësit’ në bazë të kësaj Marrëveshje Siguruese, si dhe përkundrejt çdo të mete juridike që mund të cënojë ‘Barrën Siguruese’. Në këtë kuadër, ‘Barrëdhënësi’ detyrohet të marrë pjesë në gjykimin e cdo çështje gjyqësore në mbrojtje të interesave të ‘Barrëmarrësit’, dhe zgjidhë konfliktin në favor të ‘Barrëmarrësit’. Në rast se ‘Barrëmarrësit’ i cënohet ‘Barra Siguruese’, qoftë pjesërisht apo edhe têrësisht, atëherë ‘Barrëdhënësi’ do të jetë i detyruar personalisht me të gjithë pasurinë e vet të luajtshme apo të paluajtshme, për shlyerjen e detyrimeve të ‘Kredimarrësit’ të rrjedhura nga ‘Kontrata e Kredisë’.

5.5. Në rast se persona të tretë pretendojnë të drejta pronësie, posedimi, uzufruki, enfiteoze, apo të drejta përdorimi ose ndonjë të drejte tjeter reale, ‘Barrëdhënësi’ garanton se do të ruajë të pacënuar ‘Barrën Siguruese’ të ‘Barrëmarrësit’ mbi ‘Kolateralin’.


5.6. ‘Barrëdhënësi’ do të pranojë dhe lejojë punonjësit e ‘Barrëmarrësit’, që me kërkesën e tyre, të inspektojnë dhe monitorjnë gjëndjen e ‘Kolateralit’. Gjithashtu, ‘Barrëdhënësi’ bie dakord dhe pranon, që nëse do të kërkohet nga ‘Barrëmarrësi’ rivlerësimi i ‘Kolateralit’ nga ekspertë vlerësues, të lëajojë kryerjen e rivlerësimit si dhe të mbulojë shpenzimet e lidhura me rivlerësimin përkundrejt ekspertit vlerësues të zgjedhur nga ‘Barrëmarrësi’.

Neni 6 – Të ndryshme

6.1. Çdo njoftim ose kërkesë do të konsiderohet i kryer kur bëhet me shkrim dhe dërgohet në adresat e parashikuara për palët në këtë Marëveshje Siguruese.

6.2. Në rast se ndonjë klauzolë ose detyrim sipas kësaj Marëveshje Siguruese do të jetë apo shpallet e pavlefishme, e kundërligjshme ose e pazbatueshme, - vlefshmëria, ligshmëria dhe zbatueshmëria e klauzolave ose e detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë Marëveshje Siguruese, nuk do të cënohen apo ndikojnë në zbatim.

6.3. Në zbatim të nenit 127 të Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), Rregullores Nr. 72/2020 te Bankes se Shqiperise “Për funksionimin e regjistrimit të kredive në Bankën e Shqipërisë, si dhe kushtet dhe procedurat për njohjen, përdorimin dhe rishikimin e të dhënave që administrohen në të” të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, ‘Barredhenesi’ nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Kontrate: (i) deklaron dhe garanton me vullnetin e plotë dhe të lirë se informacioni i dhënë, është i vërtetë, i saktë dhe i plotë, si dhe (ii) kuption se të dhënat demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë, do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional, si dhe për faktin se Intesa Sanpaolo Bank Albania SH.A dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjithat masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave; si dhe (iii) autorizon “Intesa Sanpaolo Bank Albania” SH.A, që për qëllimet që përfshijnë: 1. Vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi; 2. Vlerësimin e rrezikut të kredisë përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies të kredisë me Intesa Sanpaolo Bank



Albania SH.A; 3. Vlerësimin e besueshmërisë si person i lidhur me kredimarrësit;- të nijhet me detyrimet e 'Barredhenesit' ndaj institucioneve financiare kredidhënëse, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të dhënave të Regjistrat të Kredive, për të vlerësuar vlerën e ekspozimit kreditor në sistemin bankar e financiar, garancitë dhe besueshmërinë aftësinë për të shlyer detyrimet financiare.

6.3.1 'Barredhenesi' jep pëlgimin që Banka Intesa Sanpaolo Bank Albania SH.A të përdorë emrin dhe të dhënët identifikuese dhe financiare te 'Barredhenesit' për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

6.3.2 'Barredhenesi' deklaron se eshte informuar siç duhet për të drejtën për të kerkuar informacion mbi të dhënët e 'Barredhenesit' gjatë periudhës së mbajtjes së tyre nga Banka Intesa Sanpaolo Bank Albania SH.A si dhe korrigimin/rishikimin në raste kur ato janë të pa sakta, të paplota duke kupuar se çdo kërkesë për sa më sipër mund t'i a drejoje Banks Intesa Sanpaolo Bank Albania SH.A sipas detajeve te mëposhtme:

Në vëmendjen e: Departamenti te Analizes dhe Administrimit te Portofolit te Kredive

Adresa: Rr. "Ismail Qemali" No.27, Tirana, Albania

E-mail: KorrigjimRegistriKredive@intesasanpaolobank.al

Telefoni: +355 4 227 60000

Faqja e internetit: www.intesasanpaolobank.al

6.3.3 Banka do te njoftoje 'Barredhenesin' pas mënyrave te përcaktuara ne kete kontrate, per cdo ndryshim eventual te adresave te kontaktit te përcaktuara me lart.

6.3.4 'Barredhenesi' deklaron se njeh pasojat përkatëse ligjore në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, informacionit financiar dhe/ose çdo informacioni tjeter në lidhje me cilësinë e 'Barredhenesit'

6.4. Sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar 'Barrëdhënesi' në mënyrë të parevokueshme autorizon "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA të transferojë dhe të trajtojë të gjitha të dhënët personale dhe financiare të tij (më poshtë referuar si "Informacioni Konfidencial") me dhe tek Shoqeria Mëmë e saj: "Intesa Sanpaolo" S.p.A, nëse dhe sa herë që kërkohet nga Shoqeria Mëmë: "Intesa Sanpaolo" S.p.A. 'Barrëdhënesi', duke kupuar se të dhënët e tij personale dhe financiare do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar dhe profesional, si dhe duke marrë në konsideratë gjithashu se "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA dhe Shoqeria Mëmë e saj: "Intesa Sanpaolo" S.p.A kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për trajtimin e sigurt të të dhënave të 'Barrëdhënesit', autorizon "Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, - që për qëllimet që përfshijnë: 1. vlerësimin e aplikimit të 'Kredimarrësit' për kredi; dhe/ose 2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë të gjithë afatit të marrëveshjes kontraktore të kredisë së 'Kredimarrësit' me "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA; dhe/ose 3. vlerësimin e besueshmërisë së 'Kredimarrësit' së bashku me palët e treta të lidhura me 'Kredimarrësit'; dhe/ose 4. mbikëqyrja e konsoliduar nga Shoqeria Mëmë: "Intesa Sanpaolo" S.p.A [duke përfshirë por pa u kufizuar tek qëllimet e konsolidimit të pozicioneve të mëposhtme: (a) kapitalin rregullator, (b) mjastueshmërinë e kapitalit, (c) eksposimi i rrezikut, (d) pozicionet e hapura të këmbimeve valutore, (e) investimet në institucionet kapitale dhe jo kapitale]; dhe/ose 5. monitorimi dhe procesi i administrimit të rreziqeve të bankës dhe rrezikut të Grupit Bankar Intesa Sanpaolo, ose me konsolidimin e pozicioneve që parashikohen në Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar - për të transferuar dhe trajtuar të gjitha të dhënët personale dhe financiare me dhe tek Shoqeria Mëmë e saj: "Intesa Sanpaolo" S.p.A, nëse dhe sa herë që kërkohet nga Shoqeria Mëmë: "Intesa Sanpaolo" S.p.A. Në përputhje me sa më sipër, 'Barrëdhënesi' autorizon "Intesa Sanpaolo" S.p.A të ketë akses, të përdorë dhe të trajtojë të dhënët personale dhe financiare që zotëron "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA dhe/ose kjo e fundit merr në zotërim nga Regjstri i Kredive të Bankës së Shqipërisë. Gjithashu pranohet se i gjithë Informacioni Konfidencial do të mbrohet përpëra keqpërdorimit, dëmtimit, shkatërrimit, zhvlerësimit, humbjes dhe vjedhjes dhe "Intesa Sanpaolo" S.p.A nuk do të përdorë Informacionin Konfidencial për asnjë qëllim tjetër përvçese për qëllimet që përcaktohen më sipër, si dhe nuk do t'i zbulohen, vihen në dispozicion, publikohen ose përhapen palëve të treta. "Intesa Sanpaolo" S.p.A do të sigurojë që vetëm personat përgjegjës (duke përfshirë Nënkontraktorët dhe Filialët) të cilëve u zbulohet informacioni në funksion të përbushjes së qëllimeve të parashikuara më sipër, do të kenë akses të Informacionit Konfidencial. Informacioni konfidencial mund të zbulohet deri në masën e parashikuar me ligj gjykatës, zyrës së prokurorisë dhe organeve të tjera kompetente që gjëzojnë këtë të drejtë në bazë të ligjit dhe rregulloreve të zbatueshme, një gjykatësi ose çdo autoriteti rregulator. "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA dhe Shoqeria Mëmë e saj: "Intesa Sanpaolo" S.p.A do të sigurojnë respektimin nga ana e Personelit të saj (duke përfshirë Nënkontraktorët dhe Filialët) të detyrimeve për konfidencialitetin e marrë përsipër.

6.5. Gjithashu, përvèc sa përcaktohet në nenin 6.4, 'Barrëdhënesi' në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar (duke perfshire ketu por duke mos u kufizuar tek neni 6 pika 1 shkronja "a", nenin 8, si dhe te gjitha dispozitat e tjera ligjore dhe nën-ligjore të

aplikueshme) dhe Ligjit Nr. 9662 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar jep pëlqimin dhe autorizon Bankën, të përpunojë, transferojë dhe të trajtojë të dhënat personale dhe financiare të tij, me dhe tek cdo subjekt i trete, i cili kryen një ose disa shërbime në emër dhe për llogari të Bankës (duke perfshirë edhe nën-kontraktoret e tyre), me vendndodhje si brënda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës se Shqipërisë, të kontraktuar nga Banka sipas diskrecionit të Bankës, për qëllime të ushtrimit, monitorimit, vlerësimit dhe permisimit të vazhdueshëm, të aktivitetit të saj bankar dhe financiar; megjithatë duke parashikuar shprehimisht ketu se subjektet e tretë (duke perfshirë edhe nën-kontraktoret e tyre) do të janë gjithashtu përgjegjës dhe kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë së të dhënavë personale dhe financiare te 'Barrëdhënësi'.

6.5.1 Banka garanton 'Barrëdhënësin' se përpunimi i të dhënavë do të menaxhohet nga stafi teknik i zyrës përgjegjëse për trajtimin e të dhënavë personale dhe do të bëhet në përputhje me menyrat e parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", i ndryshuar.

6.5.2 'Barrëdhënësi' nëpërmjet një kërkese me shkrim drejtuar Bankës, ka të drejtë (i) të marri në çdo kohë konfirmimin përpunimin ose jo të dhënavë personale të tij, informacion për qëllimin e përpunimit, përkategoritë e të dhënavë përpunuara dhe përmarrësit e kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale të 'Barrëdhënësit'; (ii) të nijhet me përbajtjen dhe burimin e të dhënavë personale të përpunuara nga Banka; (iii) të kërkoj korrigimin ose fshirjen e tyre kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënavë Personale", i ndryshuar; (iv) të kundërshtojë, në çdo kohë, mbështetur në ligj, përpunimin e të dhënavë rreth tij. 'Barrëdhënësi' gëzon të drejtën e ankimit në rast se pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm në lidhje me të dhënat personale. Në rast se subjekti i të dhënavë ka bërë ankım, Banka nuk do të kryej ndryshime në të dhënat e tij personale deri në dhëni e vendimit. 'Barrëdhënësi', të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënavë personale, ka të drejtë t'i kërkojë kompensim Bankës për dëmin e shkaktuar.

6.6. Banka ka të drejtë që të cedoje tek personat e tretë, tërësisht ose pjesërisht, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga 'Kontrata e Kredisë', në bazë të gjykimit dhe vendimit të saj dhe pavarësisht nëse 'Kredimarrësi' ndodhet ose jo në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktore. 'Barrëdhënësi' deklaron se kupton dhe pranon që Banka do të mund të disponojë lirisht dhe të kaloj 'Kontratën e Kredisë' dhe rrjedhimisht dhe kete Kontrate, me ose pa shpërblim, më vete ose si pjesë të një portofoli kredish, tek subjekte të tretë, sipas kuadrit ligjor të zbatueshëm.

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate 'Barrëdhënësi' bie dakord të pranojë dhe ekzekutojë të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate kundrejt palës së tretë, në përputhje me Marrëveshjen e Cedimit apo Kalimit te Kontratës së Kredisë.

Për të bërë të mundur realizimin e këtij cedimi të drejtrash apo kalimi kontrate, sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, 'Barrëdhënësi' në mënyrë të parevokueshme autorizon Bankën t'i japë të dhënat personale dhe financiare të tij, të nevojshme përpara, gjatë dhe pas lidhjes së Marrëveshjes së Cedimit (duke perfshirë edhe, por pa qënë i kufizuar në shitjen apo në një formë tjeter të disponimit të kontratës) kujtdo pale me të cilën Banka deshiron të hyjë në këtë marrëdhënie cedimi apo kalimi kontrate.

6.6.1 Përvec rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj apo në aktet nën-ligjore të zbatueshme, 'Barrëdhënësi' nëpërmjet kësaj Kontrate, jep pëlqimin në mënyrë të parevokueshme se në rast mospërbushje te detyrimeve kontraktore sipas 'Kontratës së Kredisë' nga ana e 'Kredimarrësit', Banka në kuadër të rekuperimit të kredisë, pavarësisht nëse ka ndërmarrë ose jo veprimet proceduriale përbartimore, do të ketë të drejtë të përhapë, transferojë dhe/ose të përpunojë të dhënat personale dhe financiare të 'Barrëdhënësi', me cdo subjekt tjeter, në kuadër të vlerësimit paraprak apo realizimit të kalimit të Kontratës së Kredisë dhe rrjedhimisht dhe këtë Kontratë (nëpërmjet shitjes apo forma të tjera të disponimit, me ose pa shpërblim), më vete ose si pjesë të një portofoli kredish, tek subjekte të tretë, sipas kuadrit ligjor të zbatueshëm.

Neni 7– Legjislativi qe zbatohet

Kjo Marrëveshje Siguruese është objekt dhe është hartuar në përputhje me legjislatin e Republikës së Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje, konflikt ose pretendim i lindur ose i lidhur me këtë Marrëveshje Siguruese do të shqyrtohet dhe zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Neni 8 – Pranimi i Marrëveshjes

- (1) Znj. Xhuljeta Sali, shtetase shqiptare, atesia Omer, në Vlore, më dt. 16.02.1966, banuese ne Tirane, mbajtëse e Letërnjoftimit me Nr. 034244164 dhe nr. personal G65216073U, bashkëshorte e z. Refat Sali,

deklaron se është dakort të vendoset 'Barrë Siguruese' mbi 'Kolateralin' e pershkruar më sipër në favorin e 'Barrëmarrësit' si garanci për shlyerjen e detyrimeve të 'Kredimarrësit' rrjedhur nga 'Kontrata e Kredisë', dhe se pranon të gjitha efektet juridike të përcaktuara në këtë Marrëveshje Siguruese. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje Siguruese, Pranuesi i Marrëveshjes do të konsiderohet në të gjitha efektet e klauzolave të kësaj Marrëveshje Siguruese, me të njëjtën cilësi si 'Barrëdhënësi', dhe kudo ku përmendet 'Barrëdhënësi' në këtë Marrëveshje Siguruese, do të konsiderohet i përfshirë edhe Pranuesi i Marrëveshjes. Pavaresisht pretendimeve apo kundër-pretendimeve, që 'Barrëdhënësi' dhe Pranuesi i Marrëveshjes mund të kenë kundrejt njëri - tjetrit, lidhur me titullin e pronësisë apo pjestimin e 'Kolateralit', mosmarrëveshjet apo konfliktet gjyqësore ndërmjet tyre, nuk do të cënojnë apo përfshijnë në gjykimin e tyre, 'Barrën Siguruese' që 'Barrëmarrësi' përfiton mbi 'Kolateralin'.

Kjo Marrëveshje Siguruese u hartua në 4 (kater) kopje të njëjta e të barazvlefshme në gjuhën shqipe. Secila nga palët mban nga një kopje; dhe një kopje e Marrëveshjes Siguruese ruhet në Zyrën Notieriale. Interpretimi i kushteve kontraktore do të bëhet në perputhje me legjisacionin e aplikueshëm dhe qëllimin e palëve për të lidhur këtë Marrëveshje Siguruese.


Unë Noterja, ua lexova me zë të lartë palëve tekstin e kësaj Marreveshje Siguruese dhe i njoha palët me efektet ligjore të saj, ato më deklaruan se e kuptojnë atë, konstatova se palet e gjejnë Marreveshjen Siguruese në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe te plotë, dhe Unë Noterja i vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

BARRËMARRËSI

"INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SH.A

Përfaqesuar nga:

Ermenita Harasani

 Ermenita Harasani

Silvi Balliu

 Silvi Balliu


PRANUES TË MARRËVESHJES:

Xhuljeta Sali

 Xhuljeta Sali

BARRËDHËNËSI

Refat Sali

 Refat Sali

Artenisa Sali

 Artenisa Sali

NOTERE

